

## EDMOND MALAJ

## NË GJURMË TË FAMILJEVE FISNIKE RAGUZANE ME ORIGJINË NGA TROJET SHQIPTARE

Familjet fisnike raguzane me origjinë nga trojet shqiptare janë të shumta. Shqiptarët në Republikën e Raguzës, brenda qytetit dhe në zonat përreth tij filluan të vendoseshin që në shek. VI,<sup>1</sup> për shkak se në vendin e tyre pati shkatërrime të shkaktuara kryesisht nga dyndja e sllavëve por edhe e popullsisive të tjera. Më vonë, një valë tjetër pati edhe në fillimin e shek. XII<sup>2</sup>, dhe pastaj duke vazhduar edhe me ardhje të tjera sidomos në shek. XIV dhe XV, të shkaktuara këto të fundit edhe nga pushtimet osmane. Si rrjedhim dalim në konkluzionin që me origjinë shqiptare, qoftë të hershme, qoftë më të vonshme, duhet të jenë një numër i madh familjesh. Sipas studiueses Irmgard Mahnken ato përbënin pothuajse 15% të shtëpive fisnike (*nobiles*) të Republikës së Raguzës.<sup>3</sup> Pra, roli i shqiptarëve në zhvillimin dhe përparimin e kësaj republike është i padiskutueshëm.

Në artikullin e mëposhtëm do të përpiqemi t'i gjurmojmë këto familje, të japim të dhënat e para, përsa u përket atyre dhe kontributit të tyre në Raguzë duke vendosur në disa raste edhe stemat. Për këto informacione u bazuam kryesisht në të dhëna dokumentare të botuara, siç janë vëllimet e ndryshme të korpusit të madh dhe shumë të rëndësishëm për historinë e mesjetës në Ballkan me titull "*Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium*"<sup>4</sup> (Monumente që merren me

<sup>1</sup> Scriptorum, Volumen II: *Chronache di Ragusa*. Opera di Giognio de Resti, senatore di Ragusa (=Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium, Volumen XIV, Zagabriae: Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalum 1883), f. 18. (Cituat në vijim si: G. Resti, *Chronache di Ragusa ...*, f.)

<sup>2</sup> *Po aty*, f. 49.

<sup>3</sup> Irmgard Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern während des Mittelalters. Randbemerkungen zur Problematik der balkanologischen Forschung", në *Beiträge zur Südosteuropa-Forschung*. Anlässlich des I. Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26. VIII. – 1. IX. 1966. Botuar nga. Arbeitskreis Südosteuropa-Forschung bei der Deutschen *Forschungsgemeinschaft*. München: Trofenik 1966, f. 357.

<sup>4</sup> *Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium*, Volumimi I-XXX, Zagabriae: Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalum 1861-1979.

historinë e Sllavëve të Jugut), të botuar kryesisht në Zagreb (Kroaci) gjatë një harku kohor të konsiderueshëm nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Jugosllavisë, por edhe tek vëllimi me dokumente me titull “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut*” i përgatitur nga Gjon Berisha.<sup>5</sup>

Përveç këtyre vëllimeve dokumentare u përdor edhe një numër i caktuar punimesh dhe artikujsh, nga të cilët nxjerrim informacione rreth këtyre familjeve. Këtu meritojnë të përmenden artikulli i studiueses gjermane Irmgard Mahnken “*Marrëdhënie ndërmjet raguzanëve dhe shqiptarëve gjatë mesjetës*”<sup>6</sup>, si dhe punimi i saj me titull “*Patriciati Raguzan i shekullit XIV*”<sup>7</sup>, vepër të cilën nuk mundëm ta konsultojmë të plotë, por vetëm në mënyrë fragmentare. Më tej me rëndësi janë punimi i Konstandin Jireček me titull “*Romanët në qytetet e Dalmacisë gjatë Mesjetës*”<sup>8</sup> në tri pjesë, dhe artikujt e shumtë të Jahja Drançollit që janë të botuara kryesisht në vëllimin me titull “*Arbrit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë Mesjetës*”<sup>9</sup>. Punimet e tyre na ofruan material me vlerë në lidhje me praninë e shqiptarëve në Raguzë.

Krahas kërkimit të informacioneve mbi këto familje bëmë kërkime edhe në drejtim të heraldikës dhe u përpoqëm që të japim ndonjëherë edhe stemat dhe emblemat e këtyre familjeve, megjithëse, jo për të gjitha qe e mundur që të gjenden stemat përkatëse. Shpresojmë që në të ardhmen të dhënat mbi familjet fisnike me origjinë shqiptare në Raguzë të mund t’i plotësojmë dhe t’i saktësojmë dhe më tej, pasi këtu trajtohen në mënyrë hyrëse vetëm disa prej tyre.

Gjatë hulumtimit të kësaj teme hasëm në probleme të shumta: për

<sup>5</sup> Gjon Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut*, Dokumente, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë: 2018.

<sup>6</sup> Shih titullin e plotë në ref.3.

<sup>7</sup> Irmgard Mahnken, *Dubrovački patricijat u XIV veku*, Urednik Jorjo Tadić, Beograd: Srpska Akademija Nauka I Umetnosti 1960 (=Posebna Isdanja, Knjiga CCCXL; Odeljenje Društvenih Knjiga 36).

<sup>8</sup> Constantin Jireček, “Die Romanen in den Städten Dalinatens während des Mittelalters. Erster Theil”, në *Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften*, Philosophisch-Historische Klasse. Achtundvierzigster Band, Wien: Carl Gerold’s Sohn 1902, f. 1-104; Constantin Jireček, “Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters. Zweiter Theil (Schluss)”, në *Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften*, Philosophisch-Historische Klasse. Neunundvierzigster Band, Wien: Carl Gerold’s Sohn 1904, f. 1-80.

<sup>9</sup> Jahja Drançolli, *Arbrit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë Mesjetës*, Zagreb: Misioni Katolik Shqiptar Kroaci, 2008.

shembull problem kryesor është mungesa e dokumenteve këtu në arkivat tona (në Shqipëri) për këto familje, kështu që u mjaftuam për momentin me dokumente të botuara që kishim në dispozicion. Një problem tjetër është edhe mënyra se si jepet origjina e familjeve nëpër burime dhe punime të ndryshme, p. sh. në një burim ndonjë familje jepet me origjinë shqiptare, kurse në burime të tjera po e njëjta jepet me origjinë nga Bosnja, Kotorri apo Italia. Kësi rastesh kemi përmendur edhe këtu, duke cituar literaturën përkatëse. Një problem i tretë është edhe shkrimi i emrave në variante të ndryshme, duke e bërë kështu shpeshherë të vështirë identifikimin dhe përkatësinë e tyre.

Duke e mbyllur këtu këtë pjesë hyrëse po paraqesim më tej rezultatet e para të këtij hulumtimi. Në vijim vazhdojnë të dhënat për familjet sipas rendit alfabetik.

### **Aleksi (Allesio, Allexio)**

Ishin me origjinë nga Shkodra, por mesa duket edhe në Shkodër ata ishin të ardhur nga krahinat e Napolit.<sup>10</sup> Në vitin 1322 përmendet zoti Mateo de Aleksio (*Dominum Matheum de Allexio*), sipas Ranjinës kjo familje fisnike u shua në vitin 1286.<sup>11</sup> Ka shumë mundësi që këtu bëhet fjalë edhe për familje të ndryshme me të njëjtin mbiemër. Mbi stemën e kësaj familjeje nuk kemi hëpërhë të dhëna.

### **Arbanass de Bosiljevo**

Gjatë hulumtimit mbi familjet, u zbuluan edhe dy familje fisnike dalmatine, të cilat në fakt nuk bëjnë pjesë në ato të Raguzës, por në zona në afërsi të saj. Këto familje janë *Arbanass de Bosiljevo* dhe *Arbanas de Alsó-Lomnica*, të cilat na tërhoqën vëmendjen e tyre për shkak të emrit të tyre *Arbanas*.

Familja *Arbanass de Bosiljevo* mund të jetë me origjinë shqiptare duke u nisur nga vetë emri që ajo mbart. Kjo familje duhet të jetë shpërngulur në Dalmaci që në kohën e pushtimeve osmane dhe tregues për këtë mund të jetë edhe stema e familjes, ku paraqitet një kokë turku e

---

<sup>10</sup> Scriptores, Volumen I: *Annales Ragusini Anonymi item Nicolai de Ragnina* (=Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium, Volumen XIV, Zagabriae: Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalum 1883), f. 147. (Cituar në vijim si: *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ..., f. dhe *Annales Ragusini Anonymi* ..., f.)

<sup>11</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ..., f. 181.

ARBANASS de BOSILJEVO.



Fig. 1: Emblema e Arbanas de Bosiljevo. Burimi: I. von Bojničić, *Der Adel von Kroatien und Slavonien...*, Taf. 4, Bd. IV, 13.

prerë në një sfond me ngjyrë blu.<sup>12</sup> Dokumenti për njohjen e tyre si fisnikë dhe për emblemën e tyre që lëshuar nga mbreti Vladislav II në Buda të Hungarisë dhe më 4 tetor 1502 për *Ambrosius Arbanasi de Bosiljevo*. Më vonë emri i kësaj familjeje u shpall edhe në kuvendin kroat më 1604. Ajo gjendet në Matrikullin e fisnikërisë së Zagrebit dhe i përkiste edhe Komitetit të tij (*Agramer Comitatus*)<sup>13</sup>. Sipas emrit të tyre të dytë duhet të kenë jetuar në Bosiljevo të Karlovacit (Kroaci).

### Arbanas de Alsó-Lomnica

ARBANAS de ALSÓ-LOMNICA.



Fig. 2: Emblema e Arbanas de Bosiljevo. Burimi: Ivan von Bojničić, *Der Adel von Kroatien und Slavonien...*, Taf. 4, Bd. IV, 13.

Edhe *Arbanas de Alsó-Lomnica* bën pjesë ndër familjet e hershme fisnike dalmate dhe dokumenti për njohjen e tyre si fisnikë dhe për emblemën e tyre që lëshuar nga perandori Ferdinand I rreth vitit 1560, ata duket se kanë banuar për një kohë të gjatë në Dolnja Lomnica në Krahinën e Zagrebit (Kroaci)<sup>14</sup>. Nuk kemi të dhëna se ka lidhje me familjen e sipërpërmendur (*Arbanas de Bosiljevo*). Nga emri i tyre Arbanas, jemi të mendimit që duhet të kenë qenë me origjinë shqiptare.

<sup>12</sup> Ivan von Bojničić, *Der Adel von Kroatien und Slavonien*. Nach den Quellen bearbeitet von Dr Ivan von Bojničić von Knin und Plavno direktor des kön. kroat. Slav. Dalm. Landes-Archives etc. Nürnberg: Bauer un Raspe 1899, f. 5 (= J. Siebmacher's grosses und allgemeines Wappenbuch in einer neuen vollständigen geordneten und reich vermehrten Auflage mit heraldistischen und historisch-genealogischen Erläuterungen. Vierzehnten Bandes, Dreizehnte Abtheilung.)

<sup>13</sup> *Po aty*, f. 5.

<sup>14</sup> *Po aty*.

### Bassegli (Basilio)

Familja Bassegli apo Bessagli (forma të tjera të llagapit të tyre janë Basselo, Basegio, Baseyo, Basiljević, Vasiljević),<sup>15</sup> sipas Jahja Drançollit ishte me origjinë shqiptare<sup>16</sup>, kurse nëpër burime të tjera ata jepen me origjinë nga Kotorri, si për shembull tek Konstantin Jireček, i cili e radhit këtë familje ndër fisnikët e Kotorrit, dhe që prej vitit 1309, si një degë të fisnikërisë së Raguzës.<sup>17</sup>

Nga kjo familje mund të përmendim teologun dominikan Toma Bassegli nga Ragusa, lindur dhe vdekur në atë qytet (\* Raguzë, 1438 – † Raguzë, 1512) i cili u doktorua në Padova në vitin 1438 dhe dha mësim aty deri në vitin 1474. Më vonë u bë profesor i studimeve për provincën e urdhrit dominikan të Hungarisë deri në vitin 1479 dhe që nga viti 1487 qe vikar i përgjithshëm i Kongregatës së veçantë të Raguzës.<sup>18</sup> G. Lukari e rreshton këtë në listën e familjeve fisnike që ekzistonin akoma në vitin 1605.<sup>19</sup>

Përsa i përket lidhjeve të mëtejshme të kësaj familjeje me truallin shqiptar, duhet të përmendim këtu Vasiljeviqin (Vassigliovich), një ambasador të dom Giovanni Navarro, nunc apostolik i Kryqëzatës, i cili me anë të këtij ambasadori kërkonte në vitin 1458 lehtësira dhe një anije

BASSEGLI. III.



Fig. 3: Njëra nga emblemat e Bassegli. Burimi: C. Heyer von Rosenfeld, *Der Adel des Königreichs Dalmatien*, Taf. 57, Bd. IV, 3.

<sup>15</sup> *Proleksis Enciklopedija*. Versioni online. URL: <http://proleksis.lzmk.hr/11247/> (01.03.2019)

<sup>16</sup> J. Drançolli, “Bujarët arbërorë në Raguzë”, f. 126. në: Jahja Drançolli, *Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë Mesjetës*, Zagreb: Misioni Katolik Shqiptar Kroaci, 2008.

<sup>17</sup> “*Basilio, Basello, Baseglo, Baseyo, Baxeio, sp. Bassegli, sl. Basilević, Vas- (... Bac-), Fisnikë të Kotorrit, mbase pasardhësit e priorit Basilius në shek. XII (mbishkrimi 1195), e dokumentuar që prej vitit 1215. Një degë e saj, që prej 1309 ndër fisnikët e Raguzës deri në shekullin XVIII.*” C. Jireček, “Die Romanen .. Dritter Theil”, në *Denkschriften ... 49. Band*, f. 5.

<sup>18</sup> “Basiljević (Bassegli), Toma, hrvatski teolog (Dubrovnik, 1438 – Dubrovnik, 1512). Doktorirao teologiju u Padovi (1468), gdje predaje do 1474. Profesor na provincijalnom studiju dominikanske provincije Ugarske (do 1479); generalni vikar posebne Dubrovačke kongregacije (od 1487).” *Proleksis Enciklopedija*. Versioni online. URL: <http://proleksis.lzmk.hr/11247/> (1. 3. 2019)

<sup>19</sup> *Copioso Ristretto degli Annali di Rausa* di Giacomo di Pietro Luccari, Venetia: At instantia die Antonio Leonardi 1605, f. 174.

për të kaluar në Arbëri tek Skënderbeu.<sup>20</sup> Kurse mbi tregtinë e Raguzës me trojet shqiptare përmenden vëllezërit Paulus dhe Antonius Vassigliovich, të cilët merreshin me tregti druri dhe mallrash të tjera në Ishëm dhe në Rodon.<sup>21</sup> Kjo familje radhitej ndër familjen fisnike të Raguzës deri në shek. XVIII dhe ekzistonte edhe në fillim të shek. të shek. XX, e njohur si kontët Gozze-Bassegli.<sup>22</sup>

### **Berisina, Brissina, Berisna, Berissa**

Sipas J. Drançollit në Raguzë përmendet edhe familja Berissa në vitin 1430<sup>23</sup>. Të dhëna të mëtejshme në lidhje me praninë e kësaj familjeje në Raguzë hëpërhë nuk disponojmë. Nëpër dokumente na dalin disa emra anëtarësh të kësaj familjeje, si: Piçinegus de Berrisina (1278)<sup>24</sup>, më tej, Petrus de Berisna (1280-1304), vëllai i tij Laurentius de Berisna (1280-1304), Piçinegus Pasque de Berrissina, Grubessa de Berisina, Blasius de Berrisina, Pasque de Grubessa de Brissina, etj.<sup>25</sup> Për emrin Berisha (*Beriša*) Jiereçek hedh supozimin që mund të jetë edhe ndonjë derivat i emrin Berislav.<sup>26</sup>

### **Kuraca, Curaça (Curaza)**

Tjetër familje fisnike me origjinë shqiptare ishte edhe Kuraca me origjinë nga Durrësi (*de Durazo d' Arbania*)<sup>27</sup>. Nëpër dokumentet dhe analet raguzane na shfaqen disa anëtarë të kësaj familje.<sup>28</sup> Njëri prej tyre, i quajtur Mauric de Kuraxa (*Maurexa de Juraza*) shfaqet në vitin 1303, si anëtar i Këshillit të Madh, kurse një person tjetër i quajtur Savingia de Kuraca (*Savingia de Curuza*), anëtar i kësaj familjeje, shfaqet në vitin

<sup>20</sup> “Viene di nuovo don Giovanni Navar, nuncio apostolico per la cruciata; scusarseli, e darli comodita di passare in Albania dal Skenderbegh con una nostra barca; il quale tuttavia cercava ajuti dali’ ambasciatore Vassigliovich; suo ambasciatore etc.” G. Resti, *Chronache di Ragusa*, f. 352.

<sup>21</sup> Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Dokumente ...*, nr. CXL; CXLI.

<sup>22</sup> C. Jireček, “Die Romanen .... Dritter Theil”, në *Denkschriften ...49. Band.* f. 5.

<sup>23</sup> J. Drançolli, “Bujarët arbërorë në Raguzë...”, f. 126.

<sup>24</sup> C. Jireček, “Die Romanen .... Zweiter Theil”, në *Denkschriften ...49. Band.* f. 52.

<sup>25</sup> I. Mahnken, *Dubrovački patricijat ...*, f.361-362.

<sup>26</sup> C. Jireček, “Die Romanen .... Zweiter Theil”, në *Denkschriften ...49. Band.* f. 26.

<sup>27</sup> *Annales Ragusini Anonymi ...*, f. 151.

<sup>28</sup> *Po aty*, f. 151, ref 2.

1305 si kont i Malfit dhe përmendet edhe në *Libri Reformatorium* të Raguzës.<sup>29</sup> Sipas Ranjinës, i cili këtë familje e përmend me emrin *Craza*, kjo derë u shua në vitin 1363.<sup>30</sup>

### **Gondola, Gondula, Gundula (Gundulić),**

Familja Gondola, sipas Jahja Drançollit, ishte me origjinë shqiptare<sup>31</sup>, me origjinë të largët nga Lezha, pasi del degë e familjes Lukari<sup>32</sup>. Megjithatë në *Analet Anonime* të Raguzës shënojnë origjinën e tyre nga Morinje të Zetës.<sup>33</sup> Sipas Jireçekut, emri Gondola, jashtë Dubrovnikut gjendet vetëm në Zarë, ku më 1199, përmendet një “*tribunus Dobre de Gondola*”. Sipas tij, ky është i njëjti person me “Dobre de Gundula”, e cila përmendet më 1205 në një marrëveshje tregtare ndërmjet Rabit dhe Senjës.<sup>34</sup>

Një tjetër familje me mbiemrin Gondola, nga e cila kanë dalë dukë (Grafen von Gondola), jepet nëpër literaturë si me origjinë nga Etruria e Vjetër (Tuscia në Italinë e Mesme) dhe e dokumentuar në Raguzë që në vitin 930, në Lucca dhe në Tirol.<sup>35</sup> Në një dokument të vitit 1252 përmendet edhe një *Grubessa Gundule*, që ishte gjykatës i betuar

<sup>29</sup> *Monumenta Ragusina. Liber Reformatorium Tomus II. A. 1347-1352. 1356-1360. Additamentum a. 1301-1305, 1318, 1325-1336*, Zagabriae: Sumptibus Scientiarum et Artium 1882, f. 311 (=Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium. Volumen XIII); I. Mahnken, *Dubrovački patricijat u XIV veku ...*, f.43.

<sup>30</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina ...*, f. 182.

<sup>31</sup> J. Drançolli, “Bujarët arbërorë në Raguzës ...”, f. 126; shih edhe: J. Drançolli, “Arbërore Jak Pjetër Llukari – historian i epokës së humanizmit ...”, f. 365.

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> *Annales Ragusini Anonymi ...*, f. 155.

<sup>34</sup> Tadija Smičiklas, *Codex diplomaticus Croatiae, Dalmatiae et Slavoniae* - Diplomatički zbornik Kraljevine Hrvatske, Dalmacije i Slavonije: Sv.2; Listine XII, vijeka 1101-1200, Zagreb: Tisak DioničKe Tiskare 1904, f. 327-328; I. Mahnken, *Dubrovački patricijat u XIV veku ...*, f.260-261.

<sup>35</sup> Carl Georg Friedrich Heyer von Rosenfeld, *Der Adel des Königreichs Dalmatien*. Bearbeitet und gezeichnet von Carl Georg Friedrich Heyer von Rosenfeld (k. und k. Hauptmann...) Nürnberg: Bauer un Raspe 1873, f. 111 (= J. Siebmacher’s grosses und allgemeines Wappenbuch in einer neuen vollständigen geordneten und reich vermehrten Auflage mit heraldischen und historisch-genealogischen Erläuterungen. Vierten Bandes, Dritte Abtheilung.)

(*jurati iudices*)<sup>36</sup>. Në lidhje me persona të ndryshëm të familjes Gondola mund të përmendim këtu: Paul de Gondola fisnik i Raguzës që merr pjesë si dëshmitar në Dubrovnik në përpilimin e një prokure më 12 korrik 1407 ndaj tregtarit venedikas të lartpërmendur Tade Kresp. Në këtë prokurë ishte pjesëmarrës edhe Jakob de Gondola, gjykatës vjetor i së drejtës së bashkisë së Raguzës, si dhe fisniku dhe tregtari nga Tivari Marince Miroshi.<sup>37</sup> Persona të tjerë me këtë mbiemër përmend edhe Jireček, si p. sh. zotin Palë de Gondola me të bijën Donna de Gondola të përmendur në vitin 1442 dhe G. të bijën e të zotit Nikolin de Gondola të përmendur në vitin 1446.<sup>38</sup>

I njohur është edhe Johannes di Gondola nga Dubrovniku, i cili në vitin 1523 publikoi *Tabula Terrae Sancte* (Hartën e Tokës së Shenjtë) dhe disa vite më vonë shkroi edhe veprën “*Itinerario a pellegrinaggio in Tera Sancta*” (Itinerari për pelegrinazh në Tokën e Shenjtë).<sup>39</sup> Në lidhje me historinë e Skënderbeut nga familja Gondola ka edhe një ambasador, i cili shërbente pranë Skënderbeut për marrëdhëniet me Raguzën. Ky është Paladino de Gondola dhe veprimtaria e tij në shërbim të Skënderbeut është e dokumentuar në dhjetëvjeçarën e fundit të jetës së heroit.<sup>40</sup>

### **Gozula, Gozulo (Gazulli)**

Në Raguzë kemi të dokumentuar edhe familjen me origjinë shqiptare Gozulo (Gazulli). Gazullorët në shek. XV i kemi të

<sup>36</sup> Šime Ljubić, *Listine o odnašajih između južnoga Slavenstva i Mletačke republike*, Skupio i uredio Šime Ljubić, Pravi Clan Jugoslavenske Akademije znanosti i umjetnosti ITD, Knjiga I. Od godine 960 do 1335, Zagreb: U knjizarnica Jugoslavenske Akademije 1868, nr. CVI. (Në vijim cituar si: Š. Ljubić, *Listine I*, nr.)

<sup>37</sup> *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-III-563, “Dokumente për historinë e Shqipërisë së shek. XV (1406-1410)”, vëll. II, përgatitën për botim Injac Zamputi, Përparime Huta (të pabotuara), dok. nr. 138.

<sup>38</sup> “Donna G. filia Ser Pauli de Gondola 1442; G. filia olim Ser Nicolini de Gondola 1446”. C. Jireček, “Die Romanen .... Zweiter Theil”, në: *Denkschriften ...*49, Band. f. 39.

<sup>39</sup> Zoran Ladić, “Medieval Pilgrims from the Eastern Adriatic Coast to Terra Sancta and Jerusalem”, në *In viaggio verso Gerusalemme. (Walking towards Jerusalem: Cultures, Economies and Territories)*, a cura di Anna Trono, Marco Leo Imperiale e Giuseppe Marella, Salento: Congedo 2014, f. 108.

<sup>40</sup> Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Dokumente...*, nr. CLXXVII; CLXXXIX; CXC; CCXXI, etj. Në lidhje me aktivitetin e këtij ambasadori do të shkruajmë në një punim tjetër.

dokumentuar në dy degë, njërenë në Arbëri dhe tjetrën në Raguzë. Jireček i përmend si *Gasulus*, *Gačolus*, sllav. *Gazul*, që ishin qytetarë raguzan, të cilët kanë jetuar në Raguzë kryesisht gjatë shek. XV dhe që ishin shqiptar me origjinë nga Zadrima e Lezhës, ku në vitin 1416 ka ekzistuar edhe një fshat i quajtur Gasoli (Gazulli).<sup>41</sup> Ata nuk duhet të ngatërrohen me familjen fisnike raguzane me emër shumë të ngjashëm *Gauzoli*, *Gauzolo*, *Gauçolo*, të cilët po ashtu bënë pjesë në fisnikërinë raguzane nga viti 1239 deri në vitin 1326 (*Nobiles von Ragusa 1239-1326*).<sup>42</sup>

Nga kjo familje kanë dalë disa pinjollë që kanë dhënë kontribut në historinë shqiptare, sidomos në atë të Skënderbeut. Këtu mund të përmendim ambasadorët e Skënderbeut, së pari imzot Pal Gazullin<sup>43</sup> që i shërbeu Skënderbeut në vitet 1452-1459 në marrëdhëniet me Raguzën, magjistrin Gjon Gazulli që po ashtu dërgohej tek Skënderbeu nga Senati i Raguzës dhe Andrea Gazulli<sup>44</sup>, i cili e ushtroi gjithashtu detyrën e ambasadorit të Skënderbeu sidomos në vitin 1462.<sup>45</sup>

Një degë e kësaj familjeje duket se ishte shpërngulur në Raguzës në shek. XV dhe i pari i tyre atje qe Gjon Gazulli, i cili ishte i ati i Gjon (II) Gazullit, astronomit dhe diplomatit të famshëm.<sup>46</sup> Për të cilin po japim disa të dhëna. Gjon Gazulli (Johannes Gasulus) u lind në Gjadër (sot fshat midis Lezhës dhe Shkodrës), më 1400,<sup>47</sup> megjithatë G. Valentini është i mendimit se ai u lind në Raguzë.<sup>48</sup> Siç duket familja e tij duhet të ketë ikur nga rrethinat e Shkodrës qysh kur Gjoni ishte fëmijë i vogël. Ai ishte i vëllai i Pal Gazullit të cilin e përmendëm më lart.<sup>49</sup> Gjoni bëhet klerik dominikan, studion në Raguzë dhe në Padova, studime të cilat duhet t'i ketë kryer në vitin 1425<sup>50</sup>, kurse titullin doktor e ka marrë më 31

<sup>41</sup> C. Jireček, "Die Romanen .... Dritter Theil", në *Denkschriften ...49. Band*, f. 29.

<sup>42</sup> Po aty.

<sup>43</sup> Giuseppe (Zef) Valentini, *Vepra III* (Publicistikë, studime dhe tekste), përgatitur nga Ndrizim Kulla dhe Ksenofon Krisafi, përkthyer nga Dritan Thomollari, Tiranë: Plejad, 2006, f. 71-72.

<sup>44</sup> Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Dokumente...*, nr. CXC.

<sup>45</sup> G. (Zef) Valentini, *Vepra III ...*, f. 71-72.

<sup>46</sup> Po aty, f. 72.

<sup>47</sup> Robert Elsie, *A Biographical Dictionary of Albanian History*, New York/London: I. B. Tauris & Co. 2012, f. 162.

<sup>48</sup> G. (Zef) Valentini, *Vepra III...*, f. 73.

<sup>49</sup> R. Elsie, *A Biographical Dictionary...*, f. 162.

<sup>50</sup> Po aty.

janar 1430 në artet liberale.<sup>51</sup> Në vitin 1432 ai ishte në Romë dhe në Sienë së bashku me mbretin hungarez Sigismund.<sup>52</sup> Shoqërimi i mbretit gjatë kësaj kohe ishte një mision diplomatik të cilin ia kishte ngarkuar Republika e Raguzës, e cila më vonë ia ngarkon këtë mision edhe pranë Papës Nikolla V.<sup>53</sup> Misionet e tij diplomatike të ngarkuara nga Republika e Raguzës ishin të shumta. Më vonë ai përfaqësoi edhe interesat e Skënderbeut, qoftë në Raguzë, qoftë në Itali.<sup>54</sup>

Në vitin 1433 u emërua profesor i matematikës e i astronomisë në Universitetin e Padovas, dhe përveç mësimdhënies, iu përkushtua edhe ndërtimit të instrumenteve të ndryshme për astronominë.<sup>55</sup> Në vitin 1445, magjistri Gjon Gazulli gjendet përsëri në Romë dhe kjo vërtetohet nga një dokument i datës 22 qershor, ku bëhet fjalë për një letërkëmbim ndërmjet tij dhe Republikës së Raguzës.<sup>56</sup>

Në vitin 1469 mbret i Hungarisë bëhet Matia Korvini, i cili e thërret Gjon Gazullin në oborrin të vet. Gazzulli nuk shkon në Budapest, por i dërgon Korvinit një vepër të tijën, në lidhje me hulumtimet astronomike që kishte bërë.<sup>57</sup>

### **Lukari, Lucari, Lucarus, Lucaro**

Familja Lukari ishte me origjinë nga qyteti i Lezhës<sup>58</sup>, e ardhur në Raguzë në vitin 914.<sup>59</sup> Emri i tyre i vjetër ishte Lucar dhe nëpër analet raguzane, përmenden si të ardhur nga Lezha e Sllavisë (*di Lasia di Slabia*), apo nga (*Alessio di Slavia*) por që në fakt bëhet fjalë për Lezhën e Arbërisë.<sup>60</sup> Persona të shumtë që mbajnë këtë mbiemër, por edhe emrin Lukar i përmend edhe Jireçek, pa na dhënë ndonjë sqarim në lidhje me

<sup>51</sup> G. Valentini, *Vepra III ...*, f. 72.

<sup>52</sup> R. Elsie, *A Biographical Dictionary...*, f. 162.

<sup>53</sup> G. Valentini, *Vepra III ...*, f. 72.

<sup>54</sup> R. Elsie, *A Biographical Dictionary...*, f. 162.

<sup>55</sup> *Po aty*.

<sup>56</sup> Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Dokumente...*, nr. LXXXIV. (DAD, Acta Cons. Rog., vol. IX (1444-1446), fol. 164).

<sup>57</sup> G. Valentini, *Vepra III ...*, f. 73.

<sup>58</sup> Johann Christian von Engel, *Geschichte des Freystaates Ragusa*, Wien: Anton Doll 1807, f. 53.

<sup>59</sup> *Annales Ragusini Anonymi ...*, f. 155, ref 5.

<sup>60</sup> *Po aty*.

originën e tyre.<sup>61</sup>

Në lidhje me këtë familje përmenden disa pinjollë të saj. Ndër të tjerë edhe Stefan de Lukaris fisnik i Raguzës, i cili merr pjesë si dëshmitar Dubrovnik në përpilimin e një prokure më 12 korrik 1407 ndaj një tregtari venedikas, të quajtur Tade Krespi që e kishte aktivitetin e tij tregtar me qytetin e Ulqinit.<sup>62</sup> Kjo familje nuk duhet të ngatërrohet me një tjetër familje me të njëjtin emër *Lukari* që përmendet në Zarë në vitin 1283, kur u shpall i shenjtë Shën Simenoni.<sup>63</sup>

Një figurë e rëndësishme e kësaj familjeje ishte Jakobi, i biri i Pjetër Lukarit (Giacomo di Pietro Luccari), i cili në vitin 1605 botoi në Venedik një vepër me titull “*Përmbledhje e bollshme e analeve të Raguzës*” (*Copioso Ristretto degli Annali di Rausa*)<sup>64</sup>, vepër kjo e rëndësishme jo vetëm për historinë e Raguzës, por edhe për historinë shqiptare<sup>65</sup>, pasi aty jepen të dhëna edhe për ngjarje që lidhen direkt me Skënderbeun dhe me ambientin përreth tij. Interesant është këtu përmendja e një burimi të panjohur për historinë e Shqipërisë, me autor *Angiolo di Drivasto*, të cilin krahas *Marino di Scutaro* (duhet të jetë Marin Barleti) Luccari e citon për një ngjarje të vitit 1435, ku bëhet fjalë për turq të dëbuar nga Arbëria prej Andrea Topisë.<sup>66</sup> Mos vallë ky autor “*Angiolo di Drivasto*” është kryeipeshkvi Pal Engjëlli me origjinë nga Drishti dhe vepra në fjalë është *Anonimi Tivaras*, vepër që e përmend më vonë Gammaria Biemmi në historinë e tij për Skënderbeun të botuar në vitin 1756 (*Explicit Historia Scanderbegi edita per quendam albanensem*)<sup>67</sup>, por që sot nuk gjendet më asgjekund dhe nuk e ka parë



Fig. 4: Emblema e Lukari.  
Burimi: C. Heyer von  
Rosenfeld, *Der Adel des  
Königreichs Dalmatien*, Taf.  
74, Bd. IV, 3.

<sup>61</sup> C. Jireček, “Die Romanen .... Zweiter Theil”, në *Denkschriften ...49. Band.* f. 43.

<sup>62</sup> *AIH*, A-III-563, “Dokumente për historinë e Shqipërisë së shek. XV (1406-1410)”, vëll. II, dok. nr. 138.

<sup>63</sup> C. Rosenfeld, *Der Adel des Königreichs Dalmatien ...*, f. 55.

<sup>64</sup> Titulli i plotë: *Copioso Ristretto degli Annali di Rausa* di Giacomo di Pietro Luccari, Venetia: At instantia die Antonio Leonardi 1605.

<sup>65</sup> G. Luccari, *Copioso Ristretto ...*, f. 86 e më tej.

<sup>66</sup> *Po aty*, f. 91.

<sup>67</sup> “*Explicit Historia Scanderbegi edita per quendam albanensem*. Venetiis impressa industria, atque impensa erhardi Radolt de Augusta anno Domini 1480. die mensis

askush tjetër? Në këtë punim jepet edhe një e dhënë interesante. Diku në gjysmën e parë të shek. XV, bie një murtajë në Raguzë, e cila sillet nga të arratisurit e luftës që kishin ikur nga Arbëria.<sup>68</sup>

### Marini (Marinus)

Me emrin Marini hasim në radhë të parë një familje fisnike që nga Ulqini (*Nobiles von Dulcigno*), nga e cila nëpër dokumentet venedikase përmenden dy persona që janë zoti Helia Marini, gjyqtar i betuar (*Ser Helya Marini juratus judex*) i përmendur në vitin 1386 dhe Kalenda Marini e përmendur në vitin 1388.<sup>69</sup> Po me këtë mbiemër “Marini” hasim edhe një familje fisnike që ka ekzistuar në Raguzë, sipas Jirečekut, gjatë viteve 1195-1285 (*Nobiles von Ragusa 1195-1285*).<sup>70</sup> Nga literatura që disponojmë nuk mundemi akoma që të përcaktojmë, nëse këto familje me të njëjtin mbiemër kanë pasur të njëjtën origjinë, megjithatë nuk përjashtohet mundësia që të kenë pasur ndonjë lidhje.

Persona me këtë mbiemër i hasim edhe në vende të tjera të Dalmacisë, si fisnikë në Trogir (shek. XIII-XIV), ku jo shumë larg ekziston edhe sot e kësaj dite një fshat me emrin Arbanija (në ishullin Čiovo); më tej si fisnikë të ishullit Arbe (*Nobiles de Marini*) rreth vitit 1334, përmenden në ishujt Veglia (kroat. Krk) rreth vitit 1198 dhe Cherso (kroat. Cres) në vitet 1208 dhe 1226.<sup>71</sup>

### Martini

Nuk mund të rrimë pa përmendur këtu edhe familjen fisnike

---

Aprilis ducante Joanne Mocenyco inclyto Duce.” Giammaria Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh*, Seconda Edizione, Brescia: Giammaria Rizzardi 1756 [Në hyrje, pa nr. faqe, ref. 1]

<sup>68</sup> “Et fuggendo gli uomini dalli rumori, & guerre d’Albania in Rausa, portarono la peste sotto i panni, la quale consummò molta gente; ma per beneficio d’Iddio, e cura de’ magistrato fra breue se n’andò via.” G. Luccari, *Copioso Ristretto ...*, f. 91.

<sup>69</sup> C. Jireček, “Die Romanen .... Dritter Theil”, në *Denkschriften ...49. Band*, f. 39.

<sup>70</sup> Po aty.

<sup>71</sup> “3) In Spalato Ser Joannes de Marino miles 1398, Paulus de Paulo bei Schwandtner 3, 737. 4) Nobiles von Trau im XIII.-XIV. Jahrhundert. 5) Nobiles von Arbe de Marino c. 1334. 6) In Veglia: filius de Paulo de Marino 1198 K. 2, 196. 7) In Cherso Matheus Marinus 1208, Dominicus filius Mathei Marino 1226 Lj. 3, 391, 397.” *Po aty*.

Martini nga Spliti që dokumentohet gjatë shek. XVIII-XVI.<sup>72</sup> Persona me këtë mbiemër gjejmë edhe në Ulqin, si p. sh. Stephanus Marini Martini nga Ulqini i përmendur në vitin 1391.<sup>73</sup> Po ashtu si në rastin e mësipërm për momentin është e pamundur që të krijohet një lidhje midis tyre.

### Menze (Mence / Menčetić)

Edhe familja Menze, sipas J. Drançollit, mendohet se është me origjinë shqiptare.<sup>74</sup> Emrin e tyre e hasim nëpër dokumente në disa variante, si: Menze, Mencii, Mentii, Mence, Minčetić Menčetić. Jireček i përcakton si fisnikë të Tivarit në shek. XV, kurse si fisnikë raguzan i përcakton për shek. XIII-XIX.<sup>75</sup> Nëpër dokumentet raguzane ata shfaqen që në shek. XIII, si p.sh. Laurentius Uelcinne Mencij 1234, Rosinus de Menze, Menge 1243, Dimitrius Mencii, de Mence nëpër dokumente gjatë viteve 1246-1285,<sup>76</sup> dhe në një dokument të vitit 1252 *Dimitrius de Menze*, përmendet si këshilltar në njërin prej këshillave të qytetit, ose në të voglin ose në të madhin, por që në dokument nuk përcaktohet më saktë (*nos consiliari de parvo et magno consillio*)<sup>77</sup>. K. Jireček përmend emra të shumtë që mbajnë këtë mbiemër dhe si familje raguzane shfaqet e tillë që në vitin 1234.<sup>78</sup>

Në *Librat E Reformave*, përmendet më 1 dhjetor të vitit 1358 edhe një rektor i Raguzës me emri Marin de Mence (*d. rectoris ser Marini de Mence*), i cili i jep urdhër tellallit të qytetit që mos të lejohej strehimi prej askujt i Milosllavës, shërbëtores së Nikollë Shqiptarit (*Nicole Arbanensis*), dhe se nuk lejohej askush që ta largonte atë nga vendi, as nëpërmjet tokës, as nëpërmjet detit, se përndryshe personat që e bënin



Fig. 5: Emblemat e Menze.  
Burimi: C. Heyer von Rosenfeld, *Der Adel des Königreichs Dalmatien*, Taf. 10, Bd. IV, 3.

<sup>72</sup> *Po aty*, f. 40.

<sup>73</sup> “Më tej në Arbe në vitin 1190 përmendet Stephanus Martini gjyqtar- (judex)”. *Po aty*.

<sup>74</sup> J. Drançolli, “Bujarët arbërorë në Raguzë ...”, f. 126.

<sup>75</sup> C. Jireček, “Die Romanen .... Dritter Theil”, në *Denkschriften ...49. Band*, f. 42.

<sup>76</sup> *Po aty*.

<sup>77</sup> Š. Ljubić, *Listine I ...*, nr. CVI.

<sup>78</sup> C. Jireček, “Die Romanen .... Zweiter Theil”, në *Denkschriften ...49. Band*, f. 47.

këtë kundërvajtje do të dënoheshin.<sup>79</sup> Këtu nuk shpjegohet më tej se pse kërkohej kjo grua, por sigurisht shkak u ishte ndonjë vjedhje apo shkelje tjetër që mund të ketë bërë ose kundër padronit të saj Nikollë Shqiptarit, ose kundër ndonjë personi tjetër. Po këtë vit (1358) ndeshen edhe emra të tjerë që i përkisnin familjes Mence, si Mence Laurencii de Mence, Mate Mencii de Mence, Nixa Marini de Mence March de Mence, Perce Lampre de Mence, etj.<sup>80</sup>

Në vitin 1357 ndeshet Mate Nicole de Menze, si zëvendëskont i Malfit (*vicecomes de Malfi*).<sup>81</sup> Kurse në vitin 1443 përmendet një rektor i Raguzës me emrin Damiano de Mence, në lidhje me një ankesë të paraqitur para tij nga drejtuesi i një barke, i cili qe plaçkitur në krahinën e Ishmit të Arbërisë.<sup>82</sup> Emri i Damiano de Mences përmendet edhe në një dokument tjetër të datës 3 qershor në lidhje me një dëshmi për transportin e një lënde drusore po nga Ishmi, për në Ulqin e pastaj për në Raguzë.<sup>83</sup> Në këtë dokument, Damiano nuk cilësohet si rektor i Raguzës, dhe ka shumë mundësi që mund të jetë një person i ndryshëm nga i pari. Po ashtu në vitin 1465 ndeshet edhe gjykatësi Nicola de Menze në lidhje me një libër të Gjon Gazullit, që i ishte lënë trashëgim me testament zotit Juni M. de Giorgios.<sup>84</sup>

Më përpara kjo familje e kishte emrin Menza dhe ishte ndër familjet që patën vazhdimësi deri në fillim të shek. XVII, në kohën kur u botua vepra e Jakob Lukarit (1605), i cili e rreshton këtë në listën e familjeve fisnike që ekzistonin akoma në atë kohë.<sup>85</sup>

<sup>79</sup> “Die Primo Decembris. Johannes prece communis retulit, se de mandato d. rectoris ser Marini de Mence gridasse in locis solitis, quod nulla persona audeat uel presumat retinere in domo sua uel aliena Milosclauam, famulam Nicole Arbanensis, nec ipsam levare per mare nec per terram, sub pena ad voluntatem dominationis.” *Liber Reformatorium II (1347-1352) ...*, f. 253.

<sup>80</sup> *Po aty*.

<sup>81</sup> *Po aty*, f. 198.

<sup>82</sup> Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Dokumente ...*, nr. LXXXII. (DAD, Lamenta de Foris, vol. XVII, fol. 148).

<sup>83</sup> *Po aty*, dok. nr. CIII. (DAD, Lamenta de Foris, vol. XXII, fol. 93).

<sup>84</sup> *Po aty*, nr. CCVI.

<sup>85</sup> G. Luccari, *Copioso Ristretto...*, f. 174.

### Nale, Nalchus

Familja Nale, sipas Drançollit, ishte me origjinë shqiptare,<sup>86</sup> por mbetet deri më sot krejtësisht e panjohur. Jireček jep shumë të dhëna në lidhje me persona që e mbanin këtë emër, qoftë si mbiemër, qoftë si emër personi. Ndër të tjera ai përmend edhe familjen tregtare Nale (Naliescovich) të shek. XIV-XVI, pa dhënë ndonjë specifikim në lidhje me origjinën e tyre.<sup>87</sup> Jireček fjalën *Nale* e përcakton edhe si diminutiv i emrit Natalis: “*Natalis, Natalinus, Nad-*, diminutiv *Nale (-is), Nallius, Nalcho, Nalescus, sl. Naljesko*” dhe ndër të tjera thotë që si emër personi (e jo si mbiemër) hasej shumë në qytetet Saç, Ulqin dhe Tivar.<sup>88</sup>

### Numali (Numari?)

Familja Numali apo Numari ishte me origjinë nga Tivari<sup>89</sup> dhe u shua në vitin 1297.<sup>90</sup> Përsa i përket kësaj familjeje mund të cilësohet si pjesëtar i saj *Gervasius Naymeri*, i përmendur tek Ljubiç nëpër dokumente të viteve 1232 (*Gervasio Naymerii*)<sup>91</sup> dhe 1238 si një ndër gjyqtarët e betuar në lidhje me një çështje (*iurati iudices*).<sup>92</sup> Emri i tij duhet të jetë ngatërruar nga kopisti. Studiuesi kroat Speratus Nodili (ose Natko Nodilo [1834-1912]), është i mendimit që edhe personi me emrin *Jakob Negomirić*, i cili në vitin 1253<sup>93</sup> përmendet si anëtar i Këshillit të Vogël (*consiglio minore*), mund të jetë pjesëtar i kësaj familjeje.<sup>94</sup>

<sup>86</sup> J. Drançolli, “Bujarët arbërorë në Raguzë...”, f. 126.

<sup>87</sup> C. Jireček, “Die Romanen .... Zweiter Theil”, në *Denkschriften ...49. Band*, f. 48.

<sup>88</sup> Po aty.

<sup>89</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina .....*, f. 184.

<sup>90</sup> *Annales Ragusini Anonymi ...*, f. 157.

<sup>91</sup> Š. Ljubić, *Listine I ...*, nr. LXXXV, f. 47.

<sup>92</sup> Po aty, nr. LXXXII, f. 57.

<sup>93</sup> Franz Ritter von Miklosich, *Monumenta Serbica spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii*, Viennae: Apud Guilelmum Braumuller 1858, nr. XLI, f. 39.

<sup>94</sup> *Annales Ragusini Anonymi ...*, f. 157, ref 7.

### **Rekusi (Rechusi, ose Recusi)**

Familja Rekusi ishte me origjinë nga Durrësi<sup>95</sup> dhe duhet të ketë ardhur në Raguzë më 1313; pak më vonë, në vitin 1323 përmendet në Librin e Reformave (*Liber Reformatorium*) Simon de Recux si gjykatës i betuar (*juratis iudicibus*)<sup>96</sup>, emri i të cilit duhet të jetë shqiptar Rekush (*Recuš*).<sup>97</sup> G. Lukari në vitin 1605 e rreshton atë në listën e familjeve fisnike të shuara dhe e jep me emrin *Racusi*.<sup>98</sup>

### **Sagat (Sakati)**

Me origjinë shqiptare ishte edhe familja fisnike Sagat (Sakati), e cila rridhte nga krahina e Pultit.<sup>99</sup> Një nga pjesëtarët e kësaj familjeje na del i dokumentuar në Raguzë më 29. 7. 1379, si nënshtetas raguzan<sup>100</sup>. Kjo familje, sipas Shuteriqit, ka ekzistuar në Budva (Mali i Zi) dhe në lidhje me origjinën shqiptare të tyre, po sipas Shuteriqit, shërben si provë emri i fshatit Sakat në Pukë.<sup>101</sup> Kjo familje ishte e lidhur me Balshajt e me Zakariajt dhe, mesa duket, e ëma e Gjergj Aranitit ishte prej këtij fisi.<sup>102</sup>

### **Skuba, Saruba (Schuba [Saruba])**

Familja Skuba apo Saruba<sup>103</sup> ishte me origjinë nga Ulqini<sup>104</sup>. Sipas Jireček, *Saruba* apo *Sarubba*, *Zarubba*, *Carubba* njihej si familje fisnike e Raguzës (*Nobiles von Ragusa*) gjatë viteve, 1284-1349.<sup>105</sup> Jireček nuk

<sup>95</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ....., f. 185.

<sup>96</sup> *Liber Reformatorium I, (1306-1347)*..., f. 127, ref. 1.

<sup>97</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ....., f. 159, ref. 4.

<sup>98</sup> G. Luccari, *Copioso Ristretto*..., f. 175.

<sup>99</sup> Dhimitër Shuteriqi, *Moti i Madh*. Përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479, Tiranë: Dituria, 2006, f. 16.

<sup>100</sup> "Prima pars est de faciendum unam cartam sigillatam, cum sigillo nostris comunis, apertam quodmodo Nicolaus Sagat est noster Ragusinus". J. Gelicich, *Monumenta Ragusina IV* ..., f. 237.

<sup>101</sup> Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh* ..., f. 16.

<sup>102</sup> *Po aty*.

<sup>103</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ....., f. 185.

<sup>104</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ....., f. 159.

<sup>105</sup> C. Jireček, "Die Romanen .... Dritter Theil", në *Denkschriften ...49. Band*, f. 57.

thotë gjë në lidhje me origjinën e tyre. Në vitin 1303 përmendet në Librin e Reformave (*Liber Reformatorium*) Paskua de Saruba (*Pascua de Saruba*)<sup>106</sup>. Kurse tek Jireček gjejmë Piçinigus të birin e Paskue de Sarubës që përmendet në vitin 1315 (*Picinichus filius Pasque de Saruba 1315*).<sup>107</sup>

Sipas *Analeve Raguzine Anonime*, kjo familje shuhet në vitin 1348, kurse Ranjina është i mendimit se familja duhet të jetë shuar në vitin 1363<sup>108</sup>. Kronisti raguzan Nikolai Ranjina duhet të ketë të drejtë mbi datën e shuarjes së kësaj familjeje, ngaqë një pjesëtar i saj shfaqet në Librin e Reformave (*Liber Reformatorium*) në vitin 1348, dhe ky është Niko de Saruba (*Nicho de Saruba*) avokat i Kurisë së Vogël (*avocati parve curie*)<sup>109</sup>. Ai (*Nichus de Saruba*) shfaqet edhe në vitin 1349<sup>110</sup>.

### Slanze (Slavze)

Familja Slanze haset në forma të ndryshme për shkak të gabimeve të kancelarive (forma të tjera janë: Slavze, Slauze si shkak i konfuzionit në shkrimin e germave *n*, *u*, *v*), ajo ishte me origjinë nga Shkodra dhe, sipas *Analeve Anonime* u shua në vitin 1415.<sup>111</sup> Nëpër Librat e Reformave (*Liber Reformatorium*) ndeshet emri *Slavce*, *Slavoe*, *Slavi*, dhe ka mundësi që bëhet fjalë për të njëjtën familje.<sup>112</sup> Ranjina e daton shuarjen e tyre në vitin 1450.<sup>113</sup>

Tek Jireček gjejmë disa familje që kanë forma të ngjashme të këtij mbiemri, si të parin po përmendim klerikun nga Ulqini *Zan de Slau* (Slav) që gjendet nëpër dokumentet raguzane më 1242, më tej *Slavi* ose *Slavice*, që ka të bëjë me një familje fisnike nga Kotorri gjatë shek. XIV-XV që ishte identike me familjen *Maneina*.<sup>114</sup> Pra, duhet të themi që të dhënat mbi këtë familje a fis janë të pakta dhe, ngaqë ky llogaritje është

<sup>106</sup> *Liber Reformatorium II (1347-1352) ...*, f. 302.

<sup>107</sup> C. Jireček, "Die Romanen .... Zweiter Theil", në *Denkschriften ...49. Band*, f. 52.

<sup>108</sup> *Annales Ragusini Anonymi ...*, f. 159, ref 10.

<sup>109</sup> *Liber Reformatorium II (1347-1352) ...*, f. 42.

<sup>110</sup> *Po aty*, f. 61.

<sup>111</sup> *Annales Ragusini Anonymi ...*, f. 160.

<sup>112</sup> *Po aty*, f. 160, ref. 7.

<sup>113</sup> *Po aty*, f. 185.

<sup>114</sup> C. Jireček, "Die Romanen .... Dritter Theil", në *Denkschriften ...49. Band*, f. 60.



jepet emri por që ndihmoi raguzanët gjatë tre viteve të urisë, fitoi para të madhe dhe ishte shumë zemërmirë, i ndihmonte të varfërit dhe jepte para me kredi, lehtësonte situatën, ku e kishte të mundur, duke u bërë kështu një mik i madh, shok, ortak dhe vëlla i përbetuar (*fratello giurato*) me shumë raguzanë.<sup>123</sup>

Tek Jireček gjemë edhe të dhëna të tjera në lidhje me persona që mbanin këtë mbiemër, si për shembull Sergius Marini de Sorgo që përmenden në vitin 1283, Drazha, gruaja e Giv Pasque de Sorgos, (*Drase uxor Giue Pasque de Sorgo*), e përmendur në vitin 1346, Dragoe de Sorgo, Dobroslav de Sorgo, apo Tamara e veja e zotit Lukë de Sorgo, e përmendur në vitin 1443 (*Tamara, 1443 relicta Ser Luche de Sorgo*), etj., etj.<sup>124</sup>

Sipas Lukarit, më përpara kjo familje e kishte emrin Sargulo dhe bënte pjesë ndër familjet që patën vazhdimësi deri në fillim të shek. XVII, në kohën kur u botua vepra e G. Lukarit (1605), i cili e rreshton këtë në listën e familjeve fisnike që ekzistonin akoma në atë kohë.<sup>125</sup>

Jireček përmend në veprën e tij mbiemrin *Sergulo* që haset në vitin 1119 në Split,<sup>126</sup> por nuk thotë asgjë në lidhje me origjinën e tyre. Por kjo mbase nuk ka fare të bëjë me mbiemrin Sargulo që përmend Lukari. Sipas Jirečekut, kjo familje kishte edhe një linjë që në Raguzë njihej edhe me mbiemrin *Pastusina*.<sup>127</sup> Sipas Jirečekut, në shek. XIX kjo familje ishte e shuar tashmë në Raguzë, porse në Hungari duhet të kenë vazhduar të ekzistojnë më tej pasardhës të saj, pikërisht nga linja Pastusina që përmendëm më sipër, dhe që atje hasej edhe në variantin *Pesta*.<sup>128</sup>



<sup>123</sup> *Po aty*, f. 34.

<sup>124</sup> C. Jireček, "Die Romanen .... Zweiter Theil", në *Denkschriften ...49. Band*, f. 57, 59, 70, 71.

<sup>125</sup> G. Luccari, *Copioso Ristretto...*, f. 174.

<sup>126</sup> C. Jireček, "Die Romanen .... Zweiter Theil", në *Denkschriften ...49. Band*, f. 58.

<sup>127</sup> *Po aty*, f. 48.

<sup>128</sup> C. Jireček, "Die Romanen .... Dritter Theil", në: *Denkschriften ...49. Band*, f. 61.

### Spani (Spanich)

Në lidhje me Spanich (Spaniq) mendojmë se në këtë rast bëhet fjalë për një degë të familjes Spani. Familja Spani (*Span, Ispanus, Yspanus*) ishte me origjinë nga Shkodra dhe që ndër familjet kryesore fisnike në qytetin mesjetar të Drishtit.<sup>129</sup> Sipas J. Drançollit ajo ndeshet në vitin 1380 edhe në Raguzë<sup>130</sup>. Një degë të kësaj familjeje me mbiemrin Spanich (Spaniç) Jireček e gjen në ishullin Curzola në shek. XVI, kurse një degë tjetër në Shibenik (Sebenico).<sup>131</sup>

Fig. 7: Emblema e Spani.  
Burimi: C. Heyer von Rosenfeld, *Der Adel des Königreichs Dalmatien*, Taf. 49, Bd. IV 2.

### Sozigal

Familja Sozigal ishte me origjinë nga Durrësi dhe duhet të jetë shuar në vitin 1374.<sup>132</sup> Pjesëtar të kësaj familjeje gjenden edhe me mbiemrin Scoziliza nëpër Librat e Reformave (*Liber Reformatorium*). Ndoshta bëhet fjalë për to edhe kur përmenden mbiemrat *Sočibabić* ose *Sačibabič* në vëllimin dokumentar të F. Miklosiqit “*Monumenta Serbica*”.<sup>133</sup>

### Spavo (Spavaldo)

Spavo ose Spavaldo (gabimisht jepet edhe si Spanaldo) ishte një familje me origjinë nga Tivari, e cila sipas *Analeve Raguzine Anonime*, që shuar në vitin 1310.<sup>134</sup> Analet e N. Ranjinës e japin datën e shuarjes së kësaj familjeje në vitin 1363.<sup>135</sup> Një familje me një mbiemër të tillë Spavaldi (Spavaldo) e dokumentuar gjatë viteve 1278-1319 e përmend edhe Jireček, që thotë se ajo ishte një linjë e familjes Crosi, Crosio apo

<sup>129</sup> Për më gjerë rreth historisë së kësaj familjeje shih: Edmond Malaj, *Drishti. Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar*, Instituti i Historisë, QSA, Tiranë: Kristalina-KH, 2015, f. 179-186. Shih edhe: C. Jireček, “Die Romanen .... Dritter Theil”, në *Denkschriften ...49. Band*, f. 61.

<sup>130</sup> J. Drançolli “Bujarët arbërorë në Raguzë ...”, f. 126.

<sup>131</sup> C. Jireček, “Die Romanen .... Dritter Theil”, në *Denkschriften ...49. Band*, f. 61.

<sup>132</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ....., f. 185.

<sup>133</sup> F. Miklosich, *Monumenta Serbica spectantia* ..., nr. XI (1100-1200), XLI (1253).

<sup>134</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ....., f. 160.

<sup>135</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ....., f. 185.

Crusi,<sup>136</sup> që ishin me origjinë nga Kotorri dhe njihen si fisnikë të Raguzës në shek. XII-XVII.<sup>137</sup>

Librat e Reformave (*Liber Reformatorium*) e japin këtë familje të dokumentuar në vite të ndryshme në lidhje me çështje të ndryshme: Në vitin 1301 përmendet Giorgio Spavaldo që është i detyruar që të shkojë në Raguzë me gjithë familje brenda një afati të caktuar, e nëse do të vonohej, do të gjobitej me një gjobë të madhe prej 500 perperësh.<sup>138</sup> Giorgio shkoi në datën e caktuar i shoqëruar nga Johannes Spavaldo. Në tekst nuk përmendet shkaku i këtij udhëtimi të detyruar nga Këshilli i Rogatëve.

Në vitin 1305 përmendet gruaja e Gergj Spavaldos (*uxor Georgii de Spavaldo*), e cila duhej të nisej për tek mbretëresha në lidhje me dhënien e diçkaje ose me pagesën e një borxhi, por që në tekst nuk specifikohet, se çfarë është. Për udhëtimin për tek mbretëresha, gruaja e Gjergjit do të merrte nga komuna e Raguzës 80 perperë.<sup>139</sup> Në rast se ajo nuk do të shkonte, atëherë do t'i dorëzoheshin të gjitha pronat një të dërguari të mbretëreshës.<sup>140</sup> Më tej, Marinus de Spavaldo përmendet në vitin 1347<sup>141</sup>, dhe Mara e Marin de Spavaldos (*Maroe Marini de Spavaldo*) përmendet në vitin 1363<sup>142</sup>

## Stano

Familja Stano, sipas Drançollit, ishte me origjinë shqiptare,<sup>143</sup> por mbetet deri më sot krejtësisht e panjohur. Jireček përmend një formë tjetër Stanoje që i përket si mbiemër një familjeje tregtarësh dhe që mesa duket ishte me origjinë sllave<sup>144</sup>, por kjo, mendojmë që nuk ka të bëjë fare me familjen Stano të lartpërmendur.

<sup>136</sup> C. Jireček, "Die Romanen .... Dritter Theil", në *Denkschriften ...49. Band*, f. 61

<sup>137</sup> Po aty, f. 21-22.

<sup>138</sup> *Liber Reformatorium IV (1301-1336)*..., f. 2.

<sup>139</sup> *Liber Reformatorium II (1347-1352)*..., f. 311.

<sup>140</sup> Po aty.

<sup>141</sup> *Liber Reformatorium I (1306-1347)* ..., f. 277.

<sup>142</sup> *Liber Reformatorium III (1359-1364)*..., f. 304

<sup>143</sup> J. Drançolli, "Bujarët arbërorë në Raguzë ...", f. 126.

<sup>144</sup> C. Jireček, "Die Romanen .... Dritter Theil", në *Denkschriften ...49. Band*, f. 63.

### Stila (Stilla)

Familja Stila ishte me origjinë shqiptare mbetet mjaft e panjohur. Dimë vetëm se ishte me origjinë nga Shkodra dhe duhet të jetë shuar ose në vitin 1390 sipas Analeve anonime, ose në vitin 1400, sipas kronistit Nikolai Ragnina.<sup>145</sup> Në një dokument raguzan të vitit 1435 përmendet një gjyqtar me emrin Nicola Stella, në lidhje me një kontratë pune për bërjen e një valixheje lëkure udhëtimi për Gjon Gazullin<sup>146</sup>. Kurse në vitin 1439, përmendet një kancelar dhe prokurator me emrin Niksha de Stella, tek i cili depozitohen disa letra të Gjergj Kastriotit (Skënderbeut) dhe nënës së tij Jellës (?) drejtuar Republikës së Raguzës për vazhdimësinë e lidhjeve tregtare.<sup>147</sup> Jemi të mendimit që këtu mund të bëhet fjalë pikërisht për familjen Stilla dhe se, llogari mund të ketë pësuar transformime nëpër dokumente nga shkruarit e ndryshëm.

### Strepaza (Stepaza)

Familja Strepaza ishte nga Shkodra me origjinë dhe sipas Analeve Anonime duhet të jetë shuar në Raguzë në vitin 1319.<sup>148</sup> Kurse Ranjina e jep datën e shuarjes së tyre në vitin 1348, datë që duhet të jetë gabim pasi kjo familje nuk përmendet në Librat e Reformave (*Liber Reformatorium*).<sup>149</sup> Emri i kësaj shtëpie fisnike përmendet edhe në burime të tjera dokumentare, si p. sh. në një dokument që i përket vitit 1190.<sup>150</sup>

### Valkaselo

Valchaseo (*Volcoslavo?*) sipas Analeve anonime raguzane ishin nga Shkodra.<sup>151</sup> Ato na shfaqen nëpër dokumentet raguzane që në shek. XIII. Në një dokument të vitit 1252 përmendet edhe një farë *Velcassus Johannis*, që ishte këshilltar në njërin prej këshillave, ose të voglit ose të

<sup>145</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ..., f. 159.

<sup>146</sup> Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Dokumente* ..., nr. LXII.

<sup>147</sup> *Po aty*, nr. LXXII.

<sup>148</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ..., f. 160.

<sup>149</sup> *Po aty*, f. 160, ref. 2.

<sup>150</sup> Š. Ljubić, *Listine I...*, nr. XXII.

<sup>151</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ..., f. 161.

madhit, por që në dokument nuk përcaktohet se në cilin (*nos consiliari de parvo et magno consillio*).<sup>152</sup> Për këtë person mendojmë që i përkiste kësaj familje.

Ky emër nuk është i sigurt, pasi nëpër dokumente është deformuar në mënyrë të çuditshme si p. sh. *Volcay, Volcax*, etj., siç mund të shihet në vitin 1312 në regjistrin e gjatë të magjistratëve dhe të këshilltarëve të Raguzës, ku përmendet Petrus de Balisela, i cili mund të jetë edhe person prej fisit Balislava.<sup>153</sup> *Valchaseo* hasen tek Ranjina me emrin *Volchossavo*,<sup>154</sup> kurse tek annalet e Stiranit dhe tek Lukari hasen me emrin *Volcosto*.<sup>155</sup> Sipas Analeve raguzane anonime kjo familje u shua në vitin 1313,<sup>156</sup> megjithatë emri i tyre del edhe më vonë si p. sh. në Librat e Reformave të viteve të ndryshme. Ndër ta mund të përmendim Laurenc de Volkacion (Laurencius de Volcazio), i cili në vitin 1359 bëhet mbikëqyrës për drithin (massarius) e bashkisë së Raguzës, duke u betuar para rektorit.<sup>157</sup>

Studiuesit Irena Benyovsky Latin dhe Stipe Ladić në një studim të tyre e përmendin këtë familje me mbiemrin Volcassio (Vukasović) dhe e cilësojnë si një ndër familjet më të fuqishme të Raguzës në shek. XIII me një pasuri të paluajtshme të madhe,<sup>158</sup> por thonë që origjina e familjes ishte nga Bosnja.<sup>159</sup> Tani në lidhje me historinë tonë shqiptare, gjatë viteve 50 të shek. XV përmendet një dhjak që bënte detyrën e ambasadorit midis Skënderbeut dhe Raguzës. Ky person na jepet herë vetëm me emër dhe herë me emër e mbiemër në forma të ndryshme si p. sh. në vitin 1459, Ninec Vikosaliq<sup>160</sup> dhe Ninac Vukosaliq<sup>161</sup>. Jemi të

<sup>152</sup> Š. Ljubić, *Listine I...*, nr. CVI.

<sup>153</sup> "Il nome e incerto, mancando nei documenti, e essendo stranamente sformato negli elenchi. Si potrebbeno qui riferire i Volcay, Volcax, del lungo registro dei magistrati ragusei, e dei consugli, nell'anno 1312 (Libri Ref.), se non pareessero essere i Volcasso. Ivi si nomina anche un Petrus de Balisela, ma e probabile che sia un Balislava.", Š. Ljubić, *Listine I...*, nr. CVI.

<sup>154</sup> *Analii di Ragusa del N. Ragnina* ....., f. 186.

<sup>155</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ....., f. 161, ref. 4.

<sup>156</sup> *Po aty*, f. 161.

<sup>157</sup> "Clime de Mence, Laurencius de Volcazio (Cassus), Georgius Jaclie de Georgio (die II Sept.), facti fuerunt massarii bladi Comunis, qui iuraverunt in presencia domini rectoris." *Liber Reformatorium III (1359-1364)*..., f. 9.

<sup>158</sup> Irena Benyovsky Latin, Stipe Ladić, "The estate of the Volcassio Family in Medieval Dubrovnik", në *Dubrovnik Annals* 18 (2014), f. 11.

<sup>159</sup> *Po aty*, f. 13.

<sup>160</sup> Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Dokumente...*, nr. CXLV.

mendimit që këtu bëhet fjalë për një pjesëtar të kësaj familjeje dhe se emri është i shkruar në versione të ndryshme për shkak të pasaktësisë nga ana e kancelarëve dhe të shkruesve të tyre.

### **Tani**

Familja fisnike raguzane Tani ishte me origjinë shqiptare,<sup>162</sup> por mbetet deri më sot krejtësisht e panjohur. Në vitin 1465 përmendet një farë Nikollë Tani (Nicolam Tanus)<sup>163</sup> si dëshmitarë i testamentit të magjistrit Gjon Gazulli, të cilin e përmendëm më sipër. Ky nëpër dokumentet raguzane përmendet me emrin dom Nikollë Tani nga Novomonte (*dom Nicola de Tanus de Nouamonte*).<sup>164</sup>

### **Veceffi (Veresti)**

Familja *Veceffi* ose *Veresti* ishin nga Shkodra.<sup>165</sup> Në një dokument të vitit 1252 përmendet edhe një fare *Mateus Veresti*, që ishte anëtar i Këshillit të Madh (*consiglio maggiore*)<sup>166</sup> dhe më vonë edhe një Johannes, të cilin Ranjina i përmend me mbiemrin *Vezeffi*.<sup>167</sup> J. Drançolli e jep mbiemrin e kësaj familjeje si *Vecessi*.<sup>168</sup>

### **Vlaichi**

Familja Vlaichi, sipas J. Drançollit, ishte me origjinë shqiptare,<sup>169</sup> por mbetet deri më sot krejtësisht e panjohur.

<sup>161</sup> *Po aty*, nr. CXLVI.

<sup>162</sup> J. Drançolli, “Bujarët arbërorë në Raguzë...”, f. 126.

<sup>163</sup> Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Dokumente...*, nr. CCV.

<sup>164</sup> Gjon Berisha, *Arbërorët ndërmjet kishës Perëndimore dhe asaj lindore gjatë shekujve XI-XV*, Botim i dytë i plotësuar, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë: 2017, f. 459. (DAD, *Distributiones Testamenta*, vol. 11, fo. 263r.)

<sup>165</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ..., f. 161.

<sup>166</sup> Š. Ljubić, *Listine I...*, nr. CVI, viti. 1252; F. v. Miklosich, *Monumenta Serbica...*, nr. XLI, viti 1253, shih edhe *Annales Ragusini Anonymi* ..., f. 161.

<sup>167</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ..., f. 186.

<sup>168</sup> J. Drançolli, “Bujarët arbërorë në Raguzë...”, f. 126.

<sup>169</sup> *Po aty*.

## Vilanelli

Familja Vilanelli ose *Villano* (apo *Vilano*)<sup>170</sup> ishte nga Ulqini dhe mund të jetë shuar në vitin 1361.<sup>171</sup> Personat e kësaj familjeje hasen me emër të pandryshuar nëpër Librat e Reformave. Ata quheshin edhe Vetrano, dhe nuk duhet të ngatërrohen me familjen Vetrani, që ishte me origjinë nga Kotorri.<sup>172</sup>

## Vitali

Sipas Nikola Ranjinës, familja Vitali ishte nga Ulqini dhe duhet të jetë shuar në shek. XIV.<sup>173</sup> Kësaj familjeje duhet t'i ketë përkitur *Pere Ufla Vital*, i cili në vitin 1304 bënte pjesë në Këshillin e të Luturve (*Consiglio dei Pregati*). Emri Vitali haset shumë nëpër dokumentet raguzane, por duhet të thuhet këtu që ky emër nuk është vetëm llogarë familjar, por edhe emër i preferuar në Raguzë qysh në kohët e hershme dhe si rrjedhojë, jo çdo Vitali i përket familjes së sipërpërmendur.<sup>174</sup> Ndër personat që kanë këtë mbiemër mund të përmendim edhe klerikun Bubana de Vitali, i cili shërbente si noter pranë argjipeskqivit të Raguzës gjatë periudhës 1255-1262,<sup>175</sup> por për të nuk kemi të dhëna të mëtejshme.



Fig. 8: Emblema e Vitali.  
Burimi: C. Heyer von Rosenfeld, *Der Adel des Königreichs Dalmatien*, Taf. 53, Bd. IV 2.

## Viterbo

Familja Viterbo vinte nga Shkodra, porse origjinën e vjetër e kishte nga Roma dhe erdhi në Raguzë me mbretin Radoslav të Bosnjës.<sup>176</sup>

<sup>170</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ....., f. 186.

<sup>171</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ....., f. 161.

<sup>172</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ....., f. 186.

<sup>173</sup> *Po aty*.

<sup>174</sup> *Po aty*, f. 186, ref. 2

<sup>175</sup> C. Jireček, "Die Romanen .... Zweiter Theil", në *Denkschriften* ...49. Band, f. 67.

<sup>176</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ....., f. 186.

## Zarxara

Sipas Analeve anonime të Raguzës dhe historianit raguzan N. Ranjina, Zarzara-t ishin me origjinë nga Shkodra 1310.<sup>177</sup> Në vitet e para të shek. të XIV, nëpër Librat e Reformave shfaqen edhe mbiemrat e ngjashëm *Zozolus*, *Zezulus*, *Zuzulio*, që i mbante një person me emrin Marin (*Marin Zuzulio*)<sup>178</sup>, i cili ishte patric raguzan dhe në vitet 1303 dhe 1304 kishte edhe detyra në komunën e Raguzës.<sup>179</sup> Edhe i biri i tij Antoni (*Antonius filius Marini Zuzulio*) përmendet si funksionar në vitin 1314,<sup>180</sup> më saktë bëhet mbikëqyrës i tregut të kripës (*salinarius*) po atë vit (1314).<sup>181</sup>

## Zepre (Çepre)

Familja Zepre ishte me origjinë nga Tivari dhe duket se u shua në vitin 1361.<sup>182</sup> Ranjina, si vit të shuarjes jep vitin 1364, dhe e quan me emrin *Zerpe*.<sup>183</sup> Kurse në formën *Zepie* e ndeshim në Annalet e Storanit dhe në Veprën e Lukarit.<sup>184</sup> Këtë familje e përmend edhe Jireček në studimin e tij, duke dhënë si mbiemër alternativ por me pikëpyetje edhe formën “Cyprianus”. Ai e radhit atë tek familjet fisnike të Raguzës (*Nobiles von Ragusa*) për periudhën 1284-1335.<sup>185</sup>

Pjesëtarë të tjerë të kësaj familjeje ose të kësaj dere fisnike i ndeshim edhe me emra të ndryshuar, më saktë të shkruara gabim, si p. sh. *Andrea de Nicola de Zigo*, në vitin 1312 që ishte anëtar i Këshillit të Madh (*consiglio maggiore*) dhe *Vole de Zige*, që shënohet si burrë fisnik (*nobil'uomo*) dhe që në prill të vitit 1324 ishte i caktuar si rojë nate i qytetit, kurse në Librat e Reformave (*Libri reformationum*), mesa duket Zepret ndeshen edhe me mbiemrat *Zuperio* si për shembull Marinus de Nicola de Zuperio, i cili bëhet skribë (*scribanus*) në vitin 1312<sup>186</sup>; më tej

<sup>177</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ....., f. 162; *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ....., f. 186.

<sup>178</sup> *Liber Reformatorium I (1306-1347)* ..., f. 41.

<sup>179</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ....., f. 162, ref. 7.

<sup>180</sup> *Po aty*.

<sup>181</sup> *Liber Reformatorium I (1306-1347)*..., f. 41.

<sup>182</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ....., f. 163.

<sup>183</sup> *Anali di Ragusa del N. Ragnina* ....., f. 186.

<sup>184</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ....., f. 163, ref. 2.

<sup>185</sup> C. Jireček, “Die Romanen .... Dritter Theil”, në *Denkschriften ...49. Band.* f. 16, 70.

<sup>186</sup> *Liber Reformatorium I (1306-1347)*..., f. 15.

si mbiemra edhe në variantet *Zuperi*, *Zupari* (*Tolisclavi Zupari* (1312); *Marinus de Zupari* (1343))<sup>187</sup>, *Zopre*; porse në lidhje me këta emra nuk mund të duket qartë se i përkisnin familjeve patrice të Raguzës.<sup>188</sup>

Ndër personat që mbanin këtë mbiemër kemi hasur edhe Stoiano de Zepre, i cili ishte skribë në Raguzë gjatë viteve 1312-1319.<sup>189</sup> Ngaqë Jireček në punimin e sipërpërmendur e vendos në listën e familjeve romane, ka mundësi që ajo të ketë pasur një origjinë romane, edhe pse autori vetë shpreh rezerva në lidhje me origjinën e shumë prej këtyre familjeve në Dalmaci, për shkak të burimeve të pamjaftueshme.<sup>190</sup> Të dhëna të tjera rreth kësaj familjeje nuk kemi.

\* \* \*

Këto pra ishin rezultatet e para në lidhje me hulumtimin e familjeve fisnike me origjinë shqiptare (arbërore) të pranishme në Raguzë gjatë periudhës së Mesjetës.

### *S u m m a r y*

#### ON THE TRAILS OF THE NOBLE RAGUSAN FAMILIES OF ALBANIAN ORIGIN

In this paper are given the first results of the trail about the Ragusa noble families of Albanian origin and the presence of Albanians in Ragusa during the Middle Age. The papers presents historical data and for some of them are given the emblems. The data are mainly extracted from the published volumes and from the papers of different authors that have written about the Ragusa history and about Middle Age studies.

<sup>187</sup> *Po aty*, f. 15, 139.

<sup>188</sup> *Annales Ragusini Anonymi* ..., f. 163, ref. 2.

<sup>189</sup> Francesco Bettarini, "Per un censimento dei notai dalmati", në *la Rivista Dalmatica*, CXI (2014), Tab. "Ragusa", (pa nr. faqeje).

<sup>190</sup> C. Jireček, "Die Romanen .... Dritter Theil", në *Denkschriften ...49. Band.* f. 16, 70.

